

NJOFTIM
Nr. 1010, datë 21.9.2020

PËR SHPALLJEN E GARËS NË LOJËRAT E FATIT PËR KATEGORINË “KAZINO”

Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, në zbatim të neneve 34, 35, 36, 37, të ligjit nr. 155/2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 2.9.2020, “Për përcaktimin e procedurave të zhvillimit të garës, kriteret shtesë për aplikantët që konkurrojnë për t’u pajisur me licencë për kategorinë “Kazino”, procedura e shpalljes së fituesit, si dhe rastet e revokimit apo të pezullimit të kësaj licence”, shpall garën për pajisjen me licencë për zonën ku lejohet vendosja për zhvillimin e lojës së fatit, të kategorisë “Kazino”, në qytetin e Tiranës, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 689, datë 2.9.2020, “Për përcaktimin e zonës ku do të lejohet vendosja e lojës së fatit e kategorisë “Kazino”, në qytetin e Tiranës”.

1. Të interesuarit duhet të paraqesin aplikimin e tyre (kërkesë më shkrim dhe dokumentacionin shoqërues) pranë zyrave të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, deri më datë 22.10.2020, ora 16:30 CET.

2. Dokumentacioni do të paraqitet në gjuhën shqipe. Aplikanti mund të depozitojë edhe dokumente në gjuhë të huaj, të shoqëruara me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe. Aktet zyrtare të juridiksioneve të huaja duhet të shoqërohen me përkthimin e vërtetuar në gjuhën shqipe dhe të legalizohen, sipas ligjeve në fuqi dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

3. Dokumentacioni duhet të dorëzohet në dy kopje (origjinale dhe fotokopje).

Dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohen në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin dhe të jenë hartuar sipas formaliteteve të përcaktuara nga legjislacioni përkatës në fuqi.

Dokumentet, që vërtetojnë kriteret e parashikuara në legjislacionin e lojërave të fatit dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 690, datë 2.9.2020, duhet të jenë lëshuar/miratuar nga organet përkatëse, brenda 3 (tre) muajve të fundit nga data e aplikimit.

4. Shqyrtimi i dokumenteve do të bëhet pranë zyrave të Autoritetit të Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, datë 23.10.2020, ora 09:00 CET.